

## KUSH MUND TË JETË DONATOR I VESHKAVE?

Letër reth donimit të veshkave nga donues të gjallë

Përshëndetje!

Nëse ju keni marë këtë letër, ju me siguri keni një të afërm me sëmundje të veshkave dhe ky i afërm mund të jetë aktual për një transplant të veshkës. Me këtë letër ne duam t'ju infor –mojmë se si procedohet më tutje nëse ju konsideroni të dononi një veshkë.

## KUSH MUND TË DONOJË?

Për të donuar nuk nevojitet lidhje farefisërore. Ndërkaq, është më e zakonshme që donatori të gjindet në familjen e ngushtë, edhepse, shpesh të ndodh që p.sh. miq ose kolegë pune të donojnë një veshkë.

Në mënyrë që ju në përgjithësi të merreni parasysh si donator, ju duhet të gëzoni shëndet të mirë. Disa nga pengesat kryesore për të donuar janë diabeti, sëmundjet e zemrës, sëmundjet kancerogjene, sëmundjet e veshkave ose abuzimi me lëndë të ndryshme. Gratë shtatëzëna dhe persona tepër të rinj përjashtohen gjithashtu nga shqyrtimi ynë si donatorë.

Vendimi mbi donimin e veshkës merret krejtësisht me vullnet të lirë. Përpara se dikush duhet të mbajë qëndrim se nëse ai do të donojë veshkën apo jo, nevojitet informacion i kujdesshëm nga personeli i sistemit shëndetësor si dhe mbështetje nga rrethi i afërm. Nuk lejohet që të ketë ndonjë kompenzim ekonomik mes donuesit dhe pranuesit të organit. Personi i cili është në shqyrtim paraprak për donim nuk duhet t'i nënshtrohet presionit nga i sëmuri, nga familja, nga miqtë ose nga personeli i sistemit shëndetësor. Si do që vendimi të merret, ai duhet të respektohet.

**700**

PEOPLE ARE CURRENTLY WAITING FOR A KIDNEY TRANSPLANT IN SWEDEN



MORE THAN

**400**

KIDNEY TRANSPLANTS ARE PERFORMED EVERY YEAR



NEARLY

**4800**

PEOPLE HAVE DONATED A KIDNEY IN SWEDEN



MORE THAN

**16 000**

KIDNEY TRANSPLANTS HAVE BEEN PERFORMED SINCE 1964



## SHQYRTIMI

Për t'u pranuar si donator i veshkës nevojitet të bëhet një vizitë mjekësore e thelluar, e cila përfshin analizat, një graf me rreze rentgen si dhe biseda tek këshilltari social. Për t'i bërë të gjitha momentet mund të zgjasë 6 – 8 muaj, por me kryerjen e të gjitha vizitave, mjeku shqyrtues bën një gjykim përmbledhës se nëse donacioni do të jetë i mundshëm. Ky dokumentacion dërgohet më pas tek pranimi kirurgjik për transplantacion i cili më pas e thërret donuesin potencial për gjykimin final.

Shumica e donuesve të veshkës e cilësojnë momentin e donimit si një përjetim pozitiv dhe si një ngjarje me rëndësi jetike në mënyrën se si ata do t'a përceptojnë jetën e tyre dhe përkujdesjen ndaj mjedisit të tyre njerëzor.

## SI TË PARAQITEM?

Për më tepër informacion ose për të paraqitur interesim për t'u shqyrtuar si donues ju mund të kontaktoni pranimin e veshkave pranë klinikës në qytetin tuaj, shih të dhënat më poshtë.

**Faleminderit që morët nga koha e juaj për të lexuar këtë letër!**

**Ju mund të drejtoheni direkt tek ne në këto pranime të veshkave:**

**Telefonnummer 031-342 70 40**